ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **33600-24-1083-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material higjenik**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Beni Dona Plast SH.P.K.**
NUI	**810545981**
Adresa	**Ulpiana Tregu i Gjelbërt**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Ragip Mustafa**
Adresa elektronike	**prokurimi.zyra@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**09.09.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me material higjenik

Furnizim me material higjenik

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 26.08.2024 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Shërbimi Korrektues i Kosovës. Me datën 30.08.2024 përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin mbi Aprovimin e Kërkesës për Rishqyrtim si të Pjesërisht të Bazuar

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe

ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 1 – Qëllimi;
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 72- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 99 - Funksionet dhe Kompetencat e OSHP

Shkeljet e dispozitave të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, janë:
Neni 38 - Sqarimi i Tenderëve
Neni 40- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Shkeljet e dispozitave të Udhëzuesit 001/2023 për Prokurim Publik, janë:
Neni 10- Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues (AK) – **Shërbimi Korrektues i Kosovës** më datën **20.08.2024** në Platformën e E-prokurimit ka bere publikimin e Formularit – **B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku me kontrate ka shpërblyer OE: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P me çmimin total prej: 486,461.00 €.**

Pasi kemi shkarkuar nga Platforma e E-Prokurimit , Formularin – **B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar,** ne më datën **20.04.2024** kemi bere kërkese të Autoriteti Kontraktues për qasje në dokumentet e tenderit.

Autoriteti Kontraktues me datën **21.08.2024** na ka lejuar qasje në dokumentet e tenderit të Operatoreve Ekonomik qe kane ofertuar ne ketë aktivitet të prokurimit.

Kur kemi analizuar të gjithë dokumentacionin e tenderit që kemi pranuar nga AK, duke përfshi edhe ofertën e **Ndërmarrjes Tregtare Grafike Blendi O.P** , kemi konstatuar së Autoriteti Kontraktues - Shërbimi Korrektues i Kosovës gjate **Ri-vlerësimit të ofertave** ka bere shkelje substanciale të dispozitave të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës të cilat i kemi cekur në piken 6 të kësaj Ankese.

Me datën 26.08.2024 perkës platformës së E-Prokurimit kemi dërguar te AK- **Shërbimi Korrektues i Kosovës** Kërkesën për Rishqyrtim.

Në ketë Kërkese për Rishqyrtim kemi shënuar **katër (4) pretendime ankimorë** qe kane të bëjnë me vendimin e AK që ka shpërblimin me kontrate, OE-Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P me çmimin total prej: **486,461.00 €** dhe **dy (2) pretendime ankimore** që ka të bëjnë me vendimin e AK për eliminimin e kompanisë tone Beni Dona Plast SHPK nga aktiviteti i prokurimit.

AK- Shërbimi Korrektues i Kosovës me datën 30.08.2024 përmes Platformës së E-Prokurimit na e dërgon Vendimin mbi Aprovimin e Kërkesës për Rishqyrtim si Pjesërisht të Bazuar.

Bazuar në ketë vendim shihet së AK- Shërbimi Korrektues i Kosovës ka pranuar **si të bazuar vetëm pretendimin nr. 1 qe ka te beje** me vendimin e AK që ka shpërblimin me kontrate, OE-Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P, konkretisht me pretendimin tone qe ka te beje me mosdorëzimin e dëshmive të cilat AK i ka kërkuar në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit. O.P. siq janë referencat

Ndërsa me Pretendimet tjera ankimore nuk i ka trajtuar fare dhe ne vendimin e datës 30.08.2024 nuk ka dhëne asnjë përgjigjeje lidhur me këto pretendime.

Pretendimet tona ankimore lidhur me vendimin e AK që ka të beje me shpërblimin me kontrate të OE- Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P me çmimin total prej: 486,461.00 €.

Pretendimi 1:

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit (FDT) të korrigjuar me datën **26.02.2024** të neni 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe ne B54-Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara, të publikuar me datën **27.02.2024** neni - IV.2.3) Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin origjinal, te ndryshimet që ka bere të Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar:

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë të kryer me sukses kontratë a në vlere jo me pake se 300,000.00 € për furnizime të ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate.

Dëshmia 1: Listën e kontratave të realizuara me sukses 1.1 Referenca apo raporte të pranimit për kontratat e realizuara me sukses. Referencë e realizuara me Operatoret Ekonomik Privat janë të pranueshme kur të njëjtat dëshmohen me transaksione bankare apo me fatura tatimore.

OE - Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P që Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontrate, për ta plotësuar ketë kërkese së bashku me ofertën ka dorëzuar **dy lista të kontratave** të realizuara. Në baze të dhënave të shënuara në këto dy lista shihet se ky OE ka manipuluar duke shënuar në këto dy lista disa fatura me numër të njëjte dhe vlera të njëjta. Ketë dyfishim të faturave e ka bere pikërisht për shitjet që ka bere të **OE: TEKNIKA SHPK** me numër të regjistrimit të biznesit: **810133116,** që është kompani që ka ofertuar në ketë aktivitet të prokurimit dhe është në pronësi të familjares se ngushte me pronarin e kompanisë **Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.**

Këtyre Listave të kontratave **nuk ja ka bashkangjitur dëshmitë ashtu siç ka kërkuar AK – Reference apo raport të pranimit për kontratat e realizuara të AK dhe Referencat dhe transaksionet bankare apo faturat tatimore për shitjet e bëra të OE Privat.**

Të vetmet furnizime të realizuara që i kane pasur të bashkangjitura dëshmitë ashtu siç i ka kërkuar AK janë:

Shitjet që i ka bere kompanisë NTL Rilindja të shënuara ne nr. 1 të listës së pare , ne vlere prej **56,739.91 €,** (shumica e këtyre furnizimeve nuk bëjnë pjese ne grupin e materialeve higjienike por bëjnë pjese ne grupin e produkteve mbrojtëse medicionale për mbrojtje nga virusi covidit) dhe shitjet që i ka bere MPMS - Instituti Special Shtime te shënuara ne nr. 1 te listës nr. 33, ne vlere prej **782.75 €.**

Për informimin tuaj:
Person i autorizuar dhe pronare e **OE: TEKNIKA SHPK** është **Blinerë Rama**, familjare shume e afërt e Blend Ramës, personit të autorizuar të OE: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P, dhe gjithashtu familjare shume e afërte e Shaip Ramës, pronar i **OE: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.** që AK ka shpërblyer me kontrate. Legjislacioni i prokurimit publik nuk ju ndalon që të ofertojnë OE që janë në raporte të ngushta familjare(të ndërlidhur). Po kur OE që janë të ndërlidhur e keqpërdorin ketë pozite duke manipuluar gjate ofertimit dhe vlerësimit të ofertave duke mos i dërguar të gjitha dokumentet së bashku me ofertën si ne rastin konkret që nuk i kane dërguar katalogët dhe referencat e kontratave të realizuara se bashku me ofertën kur kane ofertuar por gjate vlerësimit të ofertave kur AK kërkon sqarime shtese të tenderit të tyre manipulojnë me përgjigjet e tyre varësisht së si janë të renditur sipas çmimit të ofertës. Këto veprime të këtyre dy OE, jo vetëm që janë shkelje substanciale të legjislacionit të prokurimit publik , por në konsiderojmë se me këto veprime është konsumuar edhe vepër penale. Pas analizimit të dhënave të publikuara ne Platformën e E-Prokurimit shihet se bizneset e kësaj familje këso manipulimesh kane bere edhe ne qindra aktivitete të prokurimit qe janë zhvilluar nga AK ne Republikën e Kosovës. E dimë se kjo nuk eshte vetëm qeshtje e OSHP-se, por lidhur me këto manipulime do te informohen Institucionet

tjera Ligj Zbatuese të Republikës se Kosovës. **(Dëshmi- shiko Certifikatat e Regjistrimit të Biznesit të këtyre dy OE).**

Bazuar në të dhëna e shënuara me larte qarte shihet së OE: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P, me dëshmitë qe ka dërguar ne ketë aktivitet të prokurimit nuk ka arritur as për se afërmi ta plotësojë Kërkesën 1 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional që AK ka kërkuar që vlera e realizimit të kontratave për furnizime të ngjashme të jete jo me pak së 300,00.00 €.

Pretendimi 2:

AK kontraktues ka kërkuar:
Kërkesa 2. OE duhet të përgatisë një Katalog, broshure apo diçka të ngjashme ku shihen qartë produktet e ofruara përfshire përshkrimi i tyre-përbërja etj.

Dëshmitë 2. Katalog apo broshure ku shihen qartë produktet e ofruara përfshire
përshkrimi i
tyre-përbërja etj.

OE: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P që Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontrate, **nuk ka dorëzuar së bashku me ofertën katalogun** por ka dorëzuar vetëm Specifikacionet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktues ashtu siç kane qene të shënuara në **Aneksin 1** të Dosjes së Tenderit. Ky OE as që ka marre mundin që ti hartoj dhe dërgoj specifikat teknike **për artikujt për të cilët ka ofertuar** ne ketë aktivitet të prokurimit ashtu siç ka kërkuar AK por siç e shënuam me larte vetëm i ka marre ato **"Copy Paste"** nga **Aneksi 1** të Dosjes se Tenderit pa asnjë ndryshim. Ajo çka është skandaloze, është fakti se ky OE nuk e ka shlyer nga specifikat teknike qe ka dorëzuar se bashku me ofertën as fjalën **"Ekivalent"** që AK ka shënuar ne Aneksin nr. 1 të Dosjes së Tenderit. Këto specifika teknik që ka hartuar, nënshkruar dhe vulosur OE: Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P, shume qarte e dëshmon se ky OE ka ofertuar me "**Variante".**

Pas analizimit të katalogut kemi vërejtur se të specifikat teknike qe ka paraqitur ne katalog për **11 artikuj higjenik (nr.6,32,35,37,68,71,75,76,88,97,104)** me te cilët ka ofertuar e ka të shënuar **fjalën "Ekivalent"** që edhe ky fakt shume qarte e dëshmon së ky OE ka ofertuar me "**Variante".**
Gjithashtu pas analizimit të katalogut kemi vërejtur së në specifikat teknike që ka shënuar ne katalog për **14 artikuj higjenik (nr. 15,24,25,27,29,35,56,58,64,67,73,83,98,102)** ka shënuar të dhëna **të rrejshme, mashtruese dhe manipuluese për sasinë e artikullit**

(madhësinë-vëllimin) dhe përbërjen e artikujve. Duhet theksuar se ky OE me qellim të manipulimit dhe mashtrimit të AK, për disa artikuj ne katalog nuk i ka paraqitur fotografitë e artikujve ku janë të shënuara të dhënat e artikullit - sasia (madhësia-vëllimi) dhe përbërja e artikujve por ka dërguar vetëm pjesën e fotografisë ku nuk janë të shënuara të dhënat e sasisë dhe përbërjes se artikujve. Ka raste edhe kur ka ndërhyre ne fotot e artikujve duke shlyer të dhënat në fotografi si qeshte rasti te artikulli **nr. 64- Pampersa për te rritur .** (Të dhënat me të detajuar lidhur me këta 14 artikuj i keni të shënuara në dokumentin shtese - **Tabelën e përgatitur ne Excel** ,ku saktësisht janë te pasqyruara dhe faktuara manipulimet që ka bere ky OE në katalogun që ka dërguar të AK pas kërkesës për sqarime. Ketë tabele e keni të bashkangjitur si dokument shtese së bashku me fotografitë e artikujve që ka ofertuar e ku janë të shënuar të gjitha të dhënat e artikujve - sasia – vëllimi dhe përmbajtja e artikujve). **(Dëshmi – katalogu i OE Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P dhe Tabelën që kemi përgatitur Excel).**

Lidhur me kërkesën nr. 2 – katalogun , konsiderojmë së AK gjate vlerësimit dhe Ri-vlerësimit të ofertës së OE- Ndërmarrjes Tregtare Grafike Blendi O.P, ka bere shkelje substanciale të legjislacionit të prokurimit publik duke u bazuar ne këto fakte:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së ofertës shume voluminoze, shpenzimet përgatitjes së Kërkesës për Ri shqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP dhe fitimet e pritura.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së ofertës shume voluminoze, shpenzimet përgatitjes së Kërkesës për Ri shqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP dhe fitimet e pritura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*